



Java e promovimit të gjuhës

„E gjithë arti i gjuhës, qëndron në atë që të jemi të kuptueshëm.“ (Confucius / Kong Qiu)



"Java e promovimit të gjuhës " është një program për të ndihmuar fëmijët e shkollës fillore të mësojnë gjuhën, që kryesisht synon të sigurojë ndihmën intensive për të mësuar gjuhën gjermane. Pas pushimeve të gjata verore, fëmijët përgatiten për vitin e ri shkollor nga arsimtarë dhe mbikëqyrja e përkushtuar. Në një mjedis stimulues mësimi, gjermanishtja si gjuhë e parë ose e dytë rifreskohet duke i thelluar aftësitë ekzistuese gjuhësore.

Një kërkesë e veçantë është gjithashtu përfshirja e nënave në mësimin e gjuhës, kjo është arsyeja pse ne ju ofrojmë një kurs të gjermanishtës edhe për ato, me qëllim ndihme edhe në shkollë, si dhe ato të gjinden më mirë vetë në jetën e përditshme.

Qëllimet

- Freskimi dhe përmirësimi i aftësive të gjuhës gjermane
- Përgatitja për shkollë
- Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet shkollës, prindërve dhe fëmijëve
- Kërkesa e motivimit të nxëniet të fëmijëve pjesëmarrës në kurs
- Forcimi i vetëvlerësimit të fëmijëve pjesëmarrës dhe nënave të tyre
- Forcimi i aftësive sociale dhe kompetenca ndërkulturore për të gjithë të përfshirët
- Forcimi i bashkimit dhe kohezionit social

Ofertë e programit

Java e promovimit të gjuhës JPGJ zakonisht zhvillohet në një shkollë, në javën e parë të shkollës nga ora 13:00 e deri në ora 16:00. Fëmijët janë të ndarë në tre grupmosha dhe grupi i katërt ofron kursin e gjuhës gjermane për nënat, i cili gjithashtu ka përkujdesjen për fëmijët e tyre nëse është nevoja.

Në kuadër të mësimave do të mësojnë pjesëmarrësit në veçanti të folurit, të treguarit, të lexuarit dhe të shkruarit e teksteve. Pas orëve të mësimin, kopshti opo salla do të përdoret për lojëra, për njoftime, apo për biseda.